 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt	30.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-491



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000

Prizren, Republika e Kosovës;

Tel: +381 (0) 29- 232 140;

Homepage: www.uni-prizren.com

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË STUDIMEVE THEMELORE

Prizren, Dhjetor 2019

Mbështetur në dispozitet e nenit 99 paragrafi 3 i Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, në mbledhjen e mbajtur më:27.12.2019, miratoi:

Rrregulloren për përcaktimin e kritereve themelore

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Llojet e studimeve,
2. Kohëzgjatja e studimeve,
3. Programet e studimeve,
4. Gjuha e studimeve,
5. Kushtet për pranimin dhe regjistrimin në studime,
6. Statusi i studentit,
7. Ndërrimi i drejtimit të studimeve,
8. Kalimi nga njëri fakultet në tjetrin,
9. Afatet e provimeve,
10. Puna praktike dhe profesionale,
11. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve,
12. Organizimi i studentëve,
13. Përfundimi i studimeve dhe mbrojtja e provimit përfundimtar (*diplomës*),
14. Dispozitat kalimtare, dhe të fundit.

1. Llojet e studimeve

Neni 2

1. Fakultetet e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, ofrojnë studime themelore bachelor, katërvjeçare me 8 (tetë) semestra, dhe trivjeçare me 6 (gjashtë) semestra.

Neni 3

1. Studimet themelore bachelor organizohen dhe mbahen sipas planprogramit mësimor, të miratuar nga Senati i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.
2. Planprogrami mësimor, mund të ndryshohet apo të plotësohet, ku ndryshimet apo plotësimet e planprogrameve mësimore, i miraton Senati i Universitetit, me propozimin e Këshillit të Fakultetit.

Neni 4



1. Fakultetet organizojnë studime të rregullta dhe me korrespondencë.

Neni 5

Fakultetet regjistrojnë studentë të rregullt dhe me korrespondencë, ku njësia akademike e përcakton rregulloren e brendshme, për organizimin e studimeve dhe regjistrimin e studentëve.

Neni 6

1. Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve teorike, ushtrimeve laboratorike, mësimit praktik në institucionet publike, private, seminareve, testeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavarura të studentëve, si dhe ekskursioneve me karakter mësimoro-shkencor.
2. Lënda mesimore, me pëlqimin e Këshillit të Fakultetit dhe të Dekanatit, mund të ligjërohet e përcaktuar, me javë gjatë një apo dy semestrave, ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.

Neni 7

1. Viti akademik fillon më 1 (një) tetor, dhe përfundon më 30 (tridhjetë) shtator të vitit vijues.
2. Semestri dimëror fillon me 1 (një) tetor dhe përfundon me 15 (pesëmbëdhjetë) janar të vitit vijues.
3. Semestri veror fillon më 16 (gjashtëmbëdhjetë) shkurt dhe përfundon më 31 (tridhjetë e një) të po atij viti.

2. Kohëzgjatja e studimeve

Neni 8

1. Studimet themelore bachelor, deri në përfundimin e studimeve, zgjasin tri deri në katër vjet, përkatësisht gjashtë semestra, me kërkesën që të plotësohen se paku 180 përkatësisht 240 kredi. Studenti duhet të siguroj për çdo vit të studimeve 60 (gjashtëdhjetë) kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe ato zgjedhore.
2. Kreditë duhet të fitohen:
 - ✓ Viti i parë= 60 = kredi- semestri I= 30 = kredi dhe semestri II= 30= kredi.
 - ✓ Viti i dytë= 60 = kredi= semestri (III) = 30 = kredi dhe semestri (IV)= 30 = kredi,
 - ✓ Viti i tretë= 60 = kredi= semestri (V)= 30 = kredi dhe semestri (VI)= 30 = kredi,
 - ✓ Viti i katërt=60= kredi=semestri (VII)= 30 = kredi dhe semestri (VIII)=30 = kredi, gjithsej = 240 = kredi.



3. Studimet themelore bachelor zgjasin tri vjet, përkatësisht gjashtë semestra duke kërkuar që të plotësohen së paku 180 kredi.

Studenti duhet t'i siguroj për çdo vit të studimeve, nga 60 (gjashtëdhjetë) kredi të provimet të dhëna nga lëndet e detyrueshme dhe ato zgjedhore.

Kreditë duhet të fitohen:

- ✓ Viti i parë= 60 = kredi semestri (I)= 30 = kredi dhe semestri (II)= 30= kredi,
- ✓ Viti i dytë= 60 = kredi= semestri (III)= 30= kredi dhe semestri (IV)= 30 = kredi,
- ✓ Viti i tretë= 60= kredi= semestri (V)= 30= kredi dhe semestri (VI)= 30= kredi, gjithsej 180 kredi.

Neni 9

1. Me përfundimin e suksesshëm të këtyre studimeve, studenti fiton thirrjen akademike Bachelor për programin (fakultetin) e studimeve përkatse.

3. Programet e studimeve

Neni 10

1. Fakultetet ofrojnë studime me interes dhe të përshtatshme për tregun e punës.

Neni 11

1. Programet e studimeve mund të shuhen, të ndryshohen apo të plotësohen, me propozim të Këshillit të Fakultetit me miratimin dhe propozimin e Senati dhe Këshillit Drejtues.

4. Gjuha e studimeve

Neni 12

1. Fakultetet ofrojnë studime themelore bachelor në gjuhët: shqipe, boshnjake, dhe turke.
2. Senati i Universitetit lëshon vendim të posaçëm për mbajtjen e mësimin në gjuhët e tjera zyrtare në Republikës e Kosovës.

Neni 13

1. Kandidatët e interesuar për studime në këtë Universitet, duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - ✓ Të kenë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës (*e cila vërtetohet me diplomë*);
 - ✓ Të kenë të përfunduar me sukses shkollën fillore dhe të mesme, më se paku dymbëdhjetë vjet të shkollimit (*e vërtetuar me diplomë përkatëse*),
 - ✓ Nëse kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të kenë të nostrifikuar dhe të vërtetuar diplomën nga e Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e Republikës së Kosovës.

Neni 14



1. Konkurimi, pranimi dhe regjistrimi i studentëve të rinj, bëhet në pajtim me kushtet e parapara me konkurs, të cilin e shpall Universiteti.
2. Kandidati fiton të drejtën për pranim dhe regjistrim, kur e jep provimin pranues me sukses, duke u bazuar në numrin e pikëve të fituar, të përcaktuar për pranim, për drejtimin konkurimit.
1. Provimi pranues mbahet me test, nëse në konkurs nuk parashihet ndryshe.
2. Kushtet, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues, përcaktohen përgjithësisht në konkursin e shpallur nga Universiteti.

Neni 15

1. Kandidati, i cili nuk e ka fituar të drejtën për regjistrim, ka të drejtë të bëjë ankesë për testin, që ta kontrollojë dhe të kërkojë sqarime për të.
2. Ankesa duhet t'i paraqitet Komisionit të Ankesave i themeluar nga Këshilli i Fakultetit brenda 24 (dyzet e katër) orësh, nga dita e njoftimit, përkatësisht nga dita e publikimit të rezultatit të mbajtjes së provimit pranues.
3. Komisioni i ankesave është i detyruar që të vendos më së largu brenda 48 (dyzet e tetë) orësh, pas marrjes së ankesave. Kundër këtij vendimi, kandidati ka të drejtë t'i drejtohet me ankesë komisionit të formuar ad-hoc të Senatit, në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes në shqyrtim të ankesave.

Neni 16

1. Kandidatët të cilët kanë konkuruar, duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - ✓ Fletëparaqitjen me dy fotografi;
 - ✓ Diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme (origjinali),
 - ✓ Çertifikata e lindjes,
 - ✓ Dëftesa me pagesën e përcaktuar me konkurs.
2. Dokumentet dorëzohen te referenti, nëse nuk parashihet ndryshe me konkurs.

Neni 17

1. Kandidatët e pranuar duhet t'i dorëzojnë edhe këto dokumente plotësuese:
 - ✓ Dëftesën e pagesës në emër të regjistrimit të semestrit.
 - ✓ Formularin e plotësuar për regjistrim, i cili merret në Fakultet.
2. Dokumentet plotësues, dorëzohen te referenti për çështje të studentëve brenda afatit.
3. **Statusi i studentit dhe kushtet e regjistrimit të studimeve të vitit vijues akademik**



Neni 18

1. Studentët regjistrohen vetëm me status të rregullt, nëse me konkurs nuk parashihet ndryshe.
2. Me rastin e regjistrimit, studentit i lëshohet kartela e studentit në vend të indeksit.

Neni 19

1. Regjistrimi në vitin e parë të studimeve, bëhet në kohën e përcaktuar me konkurs.
2. Regjistrimi në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt të studimeve, bëhet në kohën prej 1 deri më 15 tetor.
3. Vërtetimi i semestrave bëhet në kohën prej 2 deri më 5 mars.

Neni 20

1. Studenti i rregullt është i detyruar që të vijoj ligjëratat, ushtrimet, mësimin praktik, si dhe t'i kryej të gjitha detyrimet e tjera që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e mësimit të përditshëm, deri në përfundimin e studimeve.
2. Vijueshmërinë e mësimit të rregullt të studentit, e vërtetojnë mësimdhënësit, sipas nënshkrimeve të dhëna në fletët e evidencave.

Neni 21

1. Në mungesë të një nënshkrimi të mësimdhënësit në formularët e posaçëm, nuk ka të drejtë ta vërtetoj semestrin përkatës dhe as ta regjistroj atë vijues.
2. Përrjashtimisht, studentit i lejohet ta vërtetoj semestrin përkatës pa një nënshkrim, vetëm në raste të veçanta dhe të arsyetueshme.
3. Vendimin për këtë e merr Dekani.

Neni 22

1. Studenti ka të drejtë ta regjistroj vitin e dytë të studimeve, nëse i ka dhënë 70% të provimeve, nga numri i përgjithshëm i provimeve, ose t'i ketë fituara 41 kredi nga lëndët mësimore, të vitit të parë të studimeve.
2. Vitin e tretë të studimeve, studentit mund ta regjistroj, nëse i ka kryer 35% të provimeve, përkatësisht nëse ka fituar 20 (njëzetë) kredi, nga numri i përgjithshëm i kredive të lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.
3. Vitin e katërt, studentit mund ta regjistroj, nëse ka dhënë 30% të provimeve nga numri i përgjithshëm, përkatësisht, nëse ka fituar 18 kredi, nga lëndët mësimore të vitit të tretë të studimeve.
4. Studenti nuk mund të hyj në provime të vitit të dytë, pa i përfunduar provimet e vitit të parë; gjithashtu studentit i vitit të dytë nuk mund të hyj në provimet e vitit të tretë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të dytë, si dhe studentit i vitit të katërt nuk mund të



hyj në provimet e vitit të katërt, pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të tretë.

5. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimit nëse ka më pakë se 50 % të vijueshmërisë në legjerata dhe ushtrime në lëndën përkatëse, *(përjashtimisht me aprovimin e profesorit të arsytimit të studentit për lëndën përkatëse)*.

Neni 23

1. Studenti i cili e regjistron vitin më të lartë të studimeve, nuk ka të drejtë t'i paraqesë as të hyj në provimet e vitit vijues akademik, në qoftë se nuk i ka përfunduar më parë të gjitha provimet e mbetura të vitit paraprak të studimeve.

Neni 24

1. Studenti i cili në afatin e shtatorit nuk i fiton kreditë e parapara me nenin 22 të kësaj rregulloreje, për regjistrimin e vitit vijues, duhet ta përsërisë regjistrimin e vitit akademik.
2. Studenti i cili e përsërit regjistrimin e vitit të studimeve, paguan tarifën administrative dhe atë të shkollimit, njëlloj si studentët e tjerë të rregullt.

Neni 25

1. Studenti ka të drejtë ta përsërisë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve, më së shumti një herë, si student i rregullt.
2. Studenti i cili nuk e ka fituar të drejtën e regjistrimit, pas përsëritjes së dytë të regjistrimit, e humb statusin e studentit të rregullt.

Neni 26

1. Studenti mund të kërkoj edhe një herë gjatë studimeve, që t'i lejohet vazhdimi i studimeve edhe për një vit *(në raste të jashtëzakonshme)*
2. Kërkesa duhet të miratohet në Këshillin e Njesisë Akademike.

Neni 27

1. Këshilli i Fakultetit ka të drejtë të marrë vendime të posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në rastet kur: studentit ka të arritura të veçanta në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës dhe sportit.

Neni 28

1. Studenti mund të kërkoj pezullim të përkohëshëm nga statusi i studentit të rregullt në këto raste:
✓ Sëmundje e rëndë;



- ✓ Kujdesi për fëmijën nën moshën trivjeçare,
- ✓ Në rastet tjera të justifikueshme.

Neni 29

1. Studenti i cili i ka përfunduar të gjitha provimet e parapara me planprogram mësimor, në drejtimin përkatës, ka të drejtë të mbaj statusin e studentit të rregullt edhe një vit. Gjatë kësaj kohe, studentit duhet t'i përfundoj të gjitha provimet dhe të bëjë mbrojtjen e punimit të diplomës.

Neni 30

1. Studenti, i cili ka vërtetuar semestrin e tetë (VIII) për herë të parë, me minus dy provime të mbetura, gëzon statusin e absolventit.
2. Studenti, i cili ka vërtetuar semestrin e gjashtë (VI) për herë të parë, me minus dy provime të mbetura, gëzon statusin e absolventit (në studimet tri vjeare).
3. Statusi i absolventit zgjatë një vjet. Pas kalimit të kësaj kohe, studentit i cili nuk i ka përfunduar të gjitha provimet me sukses, humb statusin e absolventit dhe ju nënshtrohet të gjitha obligimeve që vlejné për studentët tjerë (*përsëritja e regjistrimit të vitit shkollor, pagesa e regjistrimit etj.*)

Neni 31

1. Absolventi nuk paguan tarifën administrative dhe atë të shkollimit me minus dy provime të vitit të fundit.
2. Pas kalimit të periudhës njëvjeçare të absolventit, studentit paguan tarifën administrative dhe atë të shkollimit.

Neni 32

1. Studentit e humb statusin e rregullt në këto raste:
 - ✓ Kur me dëshirë i lëshon studimet,
 - ✓ Kur t'i ketë përfunduar studimet,
 - ✓ Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve.

Neni 33

4. Kalimi nga fakultetet tjera

1. Studentit i cili është regjistruar në fakultet, ka të drejtë të bëjë transferimin në të njëjtin Fakultet, nga Fakultetet tjera përkatëse, në programë përkatëse.
2. Transferimi lejohet në kohën prej 1 deri më 15 nëntor, sipas UA-së, për transfere të MASHT-it.



3. Transferimi nga Fakultetet e tjera publike e përcakton me rregullore të veçantë secila njësi akademike.

Neni 34

1. Provimet janë publike.
Provimet për studimet themelore mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuara në tabelën e njoftimeve dhe të faqës zyrtare të internetit.
2. Afatet e rregullta të provimeve janë:
Afati i janarit- (fillon prej 20 janar deri më 15 shkurt),
Afati i qershorit- (fillon prej 6 qershorit deri më 30 qershor),
Afati i shtatorit- (fillon prej 7 shtator deri më 30 shtator).
3. Senati dhe Këshilli i Fakultetit, mund të lejojnë me vendim të veçantë edhe ndonjë afat tjetër të provimeve, si afat të jashtëzakonshëm.

Neni 35

1. Provimet e publikuara në tabelat e njoftimeve, janë detyruese, si për pyetësin ashtu edhe për studentin.
2. Numri i provimeve është përcaktuar një provim në një ditë, duke evituar mundësinë që studentin të ketë më shumë provime brenda ditës.

Neni 36

1. Orari i mbajtjes së provimeve, shpallet në fillim të vitit akademik.
2. Dekani përpilon dhe publikon orarin e provimeve, pasi t'i ketë marrë më parë datat e mbajtjes së provimeve, nga shefi për mësimin e programeve dhe drejtimeve përkatëse mësimore.
3. Ndryshimi i datës së mbajtjes së provimit, lejohet vetëm në raste të arsyeshme, nga dekanati i Fakultetit.

Neni 37

1. Paraqitja e provimeve bëhet:
Për afatin e janarit prej 15 deri më 20 janar,
Për afatin e qershorit prej 1 deri më 5 qershor,
Për afatin e shtatorit prej 25 deri më 31 gusht.
2. Paraqitja e provimit me vonesë lejohet me vendim të veçantë të Dekanit më së largu 48 orë nga mbyllja e sistemit.

Neni 38

1. Paraqitja e provimeve bëhet me kartelë dhe indeks, ose drejtpërdrejt (online), në



shërbimin e studentëve (referentëve), për çështje të studentëve.

2. Shërbimi i studentëve përpilon listën e studentëve që kanë paraqitur provimin, për çdo provim dhe në çdo afat.
3. Fletëparaqitjet e provimeve duhet të jenë valide dhe të vulosura nga referenti për çështje të studentëve.
4. Rezultatet e provimit shpallen në tabelën e shpalljeve në Fakultet dhe në sistemin e SMU-së, vetëm me numër të ID kartelës (pa emër dhe mbiemër) minimum 48 (dyzet e tetë) orë para mbajtjes së konsultimeve.
5. Notat vendosen në sistemin e SMU-së, pas mbajtjes së konsultimeve me studentët.

Neni 39

1. Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të provimit dhe konsultimeve, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh t'i vendos notat në sistemin e SMU-së, si dhe t'ia dorëzoj referentit flëtëparaqitjet bashk me listën e studentëve të provimit të kryer.

Neni 40

1. Format e mbajtjes së provimit janë:
 - ✓ Provimi me shkrim;
 - ✓ Provimi gojazi;
 - ✓ Provimi me shkrim dhe gojazi;
 - ✓ Provimi me test;
 - ✓ Provimi praktik.
2. Provimet e kombinuara me shkrim dhe gojazi, mbahen brenda afatit, në të kundërtën, provimi anulohet nga dekanati.

Neni 41

1. Vlerësimi i provimit shënohet me notë:
 - ✓ Notat 10 dhe 9 paraqesin suksesin e shkëlqyeshëm,
 - ✓ Nota 8 paraqet suksesin shumë të mirë,
 - ✓ Nota 7 paraqet suksesin e mirë,
 - ✓ Nota 6 paraqet suksesin e mjaftueshëm,
 - ✓ Nota 5 paraqet suksesin e pamjaftueshëm (të dobët).
3. Nota e vlerësimit shënohet në sistemin e SMU-së dhe në fletëparaqitje nga mësimdhënësi ose komisioni.
4. Fletëparaqitjet e provimeve të dhëna me sukses, regjistrohen në librat amëz të studentit



dhe ruhen në dosjen e studentit.

Neni 42

1. Provimet vlerësohen nga një mësuesimdhënës ose me komision.
2. Provimet me komision mbahen:
 - ✓ Kur studenti është ankuar për vlerësimin e provimit të mbajtur;
 - ✓ Kur studenti i shtrohet provimit pas herës së tretë;
 - ✓ Kur provimi është caktuar, por për raste të jashtëzakonshme mungon mësuesimdhënësi.

Neni 43

1. Studenti ka të drejtë t'i parashtrij ankesë me shkrim Dekanit, kundër notës së marrë në provim si dhe të kërkoj shikimin e testit të dorëzuar dhe të vlerësuar nga mësuesimdhënësi.
2. Ankesa duhet të parashtrihet brenda 48 orësh, pasi shpalljes së rezultateve të mbajtjes së provimit.

Neni 44

1. Dekani ose Prodekani e cakton komisionin prej tre anëtarësh, për mbajtjen e provimit.
2. Në komisionin e caktuar nuk merr pjesë mësuesimdhënësi i mëparshëm.
3. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 45

1. Provimi i dhënë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje anulohet.
2. Vendimin mbi anulimin e provimit e merr Dekani.
3. Kundër këtij vendimi, studenti ka të drejtë ankese.
4. Ankesa i paraqitet Këshillit të Fakultetit, brenda 48 (dyzetë e tetë) orësh nga dita e njoftimit për këtë.

Neni 46

1. Studenti ka të drejtë të kërkoj shtyrjen e mbajtjes së provimit, vetëm në rastet e arsyeshme dhe të justifikueshme.
2. Vendimin për këtë e merr Dekani ose Prodekani.

8. Mësimi praktik

Neni 47

1. Fakultetet e Universitetit kanë praktik ku secila prej njësive akademike i ka specifikat e veta. Prandaj, çdo fakultet ka Rregulloren e vet të brendshme për mësimin praktik.



Mësimdhënësit e Fakulteteve janë të detyruar t'i mbikëqyrin studentët në institucionet ku janë duke mbaruar mësimin praktik.

Neni 48

1. Mësimi praktik organizohet dhe mbahet nëpër institucione publike dhe private.

9. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 49

1. Studentët e pranuar kanë këto të drejta:

- ✓ Te marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, ushtrime teorike, ushtrime laboratorike, mësim praktik, punë në teren, seminare, diskutime shkencoro-mësimore, konsultime profesionale, ekskursione me karakter mësimoro-shkencor si dhe në forma të tjera të mësimit që organizohen me plan dhe program mësimor;
- ✓ Të përdorin pasqiet e fakultetit sipas rregullave përkatëse për mësim dhe ushtrime mësimore.
- ✓ Ta shfrytëzojnë bibliotekën e fakulteteve në pajtim me rregullat përkatëse mbi punën e bibliotekës;
- ✓ Të marrin pjesë në zgjedhjet e studentëve për përfaqësimin e tyre në organet e Fakultetit dhe atë universitare;
- ✓ Të marrin pjesë në mbledhjet e organeve dhe të komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe përgjegjësi;
- ✓ Të përfitojnë bursa studimi dhe shpërblime të veçanta, që jepen nga Fakulteti apo nga universiteti, atëherë kur i plotësojnë kushtet për të;
- ✓ Të kërkojnë lirim nga pagesa e tarifës së regjistrimit, kur i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs që e publikon universiteti;
- ✓ Të kërkojnë të njihen me rregullat e përcaktuara mbi studimet themelore në këtë Fakultet.

Neni 50

1. Studenti i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore dhe statutore sipas kësaj rregulloreje apo të ndonjë vendimi të Dekanit të Fakultetit, gjatë tërë kohës së studimeve, bënë një shkelje të obligimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.

Neni 51



1. Me rregulloren mbi procedurën disiplinore të Universitetit, përcaktohen shkeljet e lehta apo më të rënda të detyrimeve të studentit, përcaktimi dhe procedura e përgjegjësisë disiplinore, shqiptimi i masave disiplinore si dhe të drejtat për ankesat e studentëve.

Neni 52

1. Studenti ka të drejtë të ankohet kundër çdo vendimi me të cilin konsideron se është bërë shkelje e të drejtave të tij gjatë kohës së studimeve.
2. Ankesa paraqitet:
 - ✓ Kundër vendimit të Dekanit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë - Këshillit të Fakultetit;
 - ✓ Kundër vendimit të komisionit për studime, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë, komisionit për ankesa të këtij fakulteti;
 - ✓ Kundër vendimit të Këshillit të Fakultetit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë Senati i universitetit.

10. Organizimi i studentëve

Neni 53

1. Interesat e studentëve realizohen drejtpërsëdrejti në Këshillin e Studentëve dhe përmes përfaqësimit të tyre në:
 - ✓ Këshillin e Fakultetit.

Parlamentin e Studentëve.

Neni 54

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore.
2. Themelimi i organizatave studentore bëhet në pajtim me statutin dhe rregulloret që i miraton Parlamenti i Studentëve të Universitetit.

11. Përfundimi i studimeve dhe mbrojtja e provimit përfundimtar (mbrojtja e diplomës)

Neni 55

Studimet themelore tri apo katër vjeçare bachelor në fakultet, përfundojnë pas dhënies së provimit përfundimtar (mbrojtjes së diplomës). Përgatitja dhe kushtet e temës së diplomës përcaktohen me rregullore për punimin e diplomës.

Neni 56

1. Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar pasi t'i ketë përfunduar më parë të gjitha provimet e parapara dhe t'i ketë grumbulluar së paku 240 përkatësisht 180 kredi të nevojshme, në emër të provimeve të dhëna, si dhe pasi t'i ketë kryer të gjitha obligimet



tjera të parapara me ligj, statut si dhe me këtë Rregullore.

2. Të dhënat për plotësimin e këtyre kushteve i kontrollon dhe i vërteton Sekretari i Fakultetit.

Neni 57

Afati për mbrojtjen e provimit përfundimtar (diplomës) përcaktohet sipas rregullores për përpilimin, paraqitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës.

Studentët mund të diplomojnë pasi t'i kenë kryer procedurat administrative,

Studimet bachelor në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren përfundojnë me mbrojtjen e punimit të diplomës, në pajtim me programin e studimeve.

Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marrë temën bachelor.

Studenti mund të aplikoj për parashtrim të temës bachelor me rastin e regjistrimit të semestrit të 6-të (gjashtë) të studimet tre vjeçare përkatësishtë semestrit të 8-të, në studimet katër vjeçare.

Neni 58

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës) është publike.
2. Mbrojtja e provimit përfundimtar bëhet para komisionit prej tre anëtarësh.
3. Komisionin e cakton dekani ose prodekani, në bashkëpunim me shefat e programeve mësimore.
4. Të drejtë mentorimi kanë profesorët me titull shkencor, doktor i shkencave.

Neni 59

1. Komisionin për mbrojtjen e temave i propozohet departamentit dhe i miraton Këshilli i Fakultetit.

Neni 60

1. Pas përfundimit të semestrit të fundit, studenti ka të drejtë që në periudhën prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, t'i përfundoj provimet përkatësisht ta përfundoj periudhën e diplomimit, të diplomoj.
2. Gjatë kësaj periudhe studenti nuk paguan tarifa të parapara për shkollim.
3. Nëse studenti nuk diplomon gjatë kësaj periudhe, ai duhet të përsërisë regjistrimin e vitit të fundit (vitin e katërt) të studimeve dhe të paguaj tarifën e shkollimit për studime të rregullta, në lartësinë e pagesës ashtu si studentët e rregullt.
4. Nëse studenti nuk diplomon edhe pas këtij regjistrimi të përsëritur, për herë të dytë, të vitit të tretë të studimet tre vjeçare dhe katërt të studimeve katër vjeçare, ai humb të drejtën e studentit të rregullt dhe është i detyruar që t'i paraqesë kërkesë Dekanit për t'ia zgjatur



statusin dhe për një vitë.

Neni 61

1. Në provimin përfundimtar (diploma), studenti duhet të tregoj dituri dhe aftësi teorike, që ka arritur gjatë kohës së studimeve, në përvetësimin e temës së dhënë, duke vërtetuar se temën e ka punuar me metodat që i përgjigjen punimit, se e njih literaturën dhe di ta përdori atë në mënyrë profesionale dhe të pavarur.

Neni 62

1. Provimi përfundimtar paraqet punën e pavarur dhe profesionale të një problemi ose detyrë të caktuar teorike, metodologjike ose profesionale.
2. Provimi përfundimtar shtjellohet dhe mbrohet individualisht.
3. Në raste të veçanta, me vendim të posaçëm të Këshillit të Fakultetit, mund të lejohet shtjellimi dhe mbrojtja e provimit përfundimtar, së bashku me dy apo tre studentë.

Neni 63

1. Paraqitja për mbrojtjen e provimit përfundimtar bëhet në administratën e Fakultetit, te referenti apo te personi i autorizuar për këtë çështje.
2. Formularët për paraqitje, merren te personi i autorizuar për këtë.
3. Formulari plotësohet me të gjitha të dhënat për studentin, që paraqitet për mbrojtjen e provimit përfundimtar.
4. Krahas kërkesës për paraqitjen e provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe:
 1. Indeks in ose ID kartelën.
 2. Fletëparaqitjen për provimin përfundimtar e cila merret te referenti për çështje të studentëve,
 3. Dy ditarët e mësimit praktik,
 4. Projekt prezantimi.

Neni 64

1. Provimi përfundimtar përbëhet prej tri pjesëve dhe vlerësohet maksimalisht deri në 100 pikë (detajet në rregulloren përkatëse të Fakultetit).
2. Nota përfundimtare në mbrojtjen e provimit përfundimtar nxjerret sipas pikëve të grumbulluara në pasqyrën tabelare si vijon:



<u>Pikët</u>	<u>Nota</u>
91—100	10
81-90	9
71-80	8
61-70	7
51-60	6

Neni 65

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës) mbahet me procesverbal.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit dhe Dekani.
3. Procedimi i provimit përfundimtar (procesverbali) ka këtë formë dhe mbanë këto të dhëna:
 - ✓ Të dhënat e nevojshme për kandidatin dhe për temën;
 - ✓ Pikët e fituara gjatë mbrojtjes së provimit përfundimtar;
 - ✓ Notën mesatare;
 - ✓ Thirrjen e fituar bachelor për programin mësimor apo drejtimin mësimor;
 - ✓ Datën e mbajtjes së provimit përfundimtar;
 - ✓ Nënshkrimin e anëtarëve të komisionit;
 - ✓ Nënshkrimin e Dekanit.

Neni 66

1. Studenti i cili me sukses e mbron provimin e diplomës, fiton titullin bachelor për programin mësimor apo për drejtimin mësimor të përfunduar.

Neni 67

1. Studenti i cili e kryen me sukses provimin përfundimtar, i lëshohet çertifikatë në emër të diplomës, për mbarimin e studimeve trivjeçare ose katërvjeçare bachelor të programit mësimor të përfunduar.
2. Diplomën e nënshkruajnë Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit.

Neni 68

1. Diploma i dorëzohet studentit në mënyrë solemne. Promovimi i studentëve të diplomuar bëhet sipas rregullave të cilat i përcakton Universiteti, në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit.

Neni 69



1. Administrata e Fakultetit mbanë evidencën e studentëve të diplomuar.



12. Dispozitat kalimtare

Neni 70

1. Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit nga Senati i universitetit.

Neni 71

1. Studentët që nuk kanë mundur t'i përfundojnë studimet gjatë periudhës së caktuar kohore, janë te detyruar t'i vazhdojnë dhe t'i përfundojnë studimet sipas kësaj rregulloreje.

Neni 72


Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikë e Kosovës, Statutin e Universitetit dhe aktet e tjera normative.

Neni 73

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen në mënyrën e njëjtë, ashtu siç është miratuar.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit, shfuqizohen rregulloret, vendimet apo udhëzimet e tjera të mëparshme të kësaj natyre.
3. Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati i Universitetit.



Kryesues i Senatit të Universitetit



Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj

